



MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES

- Ligjet e reja te sektorit energjetik
 - Paketa e Trete e Energjise ne sektorin energjetik shqiptar
-
- **Agim BREGASI: Drejtor i Politikave Elektroenergjetike**

Tirane, 29 Teor 2012

Reformat ne sektorin e energjise elektrike

- Per te garantuar nje furnizim te sigurt te konsumatoreve me energji elektrike, duhej qe ne sektorin elektroenergjetik te ndermerreshin nje sere reformash, ku nder me kryesoret mund te permendim:
 1. Reformen legjislative;
 2. Reformen organizative;
 3. Reformen tarifore
 4. Reformen e infrastruktures energjetike

Reforma Ligjore

Reforma ligjore ishte e domosdoshme per te paraprire gjithë reformen ne sektorin elektroenergjetik dhe vecanerisht ne ate organizative, per ta kaluar kete sektor nga nje ekonomi e centralizuar ne nje ekonomi te bazuar ne ligjet e ekonomise se tregut.

- Ligji nr. 8987, date 24.12.2002 "Per krijimin e kushteve lehtesuese per ndertimin e burimeve te reja te prodhimit te energjise elektrike", si dhe vendimi perkatese me te njejtin emer.
- Ligji nr. 9072, date 22.5.2005 "Per sektorin e energjise elektrike", me amendimet e tij.
- Ligji nr. 9663, date 18.12.2006 "Per Koncesionet"
- Vendimi nr. 27, date 19.1.2007, "Per miratimin e rregullave per vleresimin dhe dhenien e koncesioneve"
- Vendimi nr. 1701, date 17.12.2008 "Rregullat dhe procedurat per dhenien e Autorizimeve per ndertimin e objekteve gjeneruese, qe nuk jane objekt koncesioni"

Ligjet e reja te sektorit

- Zhvillimet e reja ne kuadrin ligjor te sektorit elektroenergjetik jane:
- Hartimi i tre draft ligjeve baze te sektorit energjetik dhe konkretisht:
- (i) draft ligji “Per energjite e rinovueshme”
- (ii) draft ligji “Per eficencen e energjise” dhe
- iii) draft ligji “Per sektorin e energjise elektrike”.

Keto ligje do te jene ne perputhje te plote me direktivat perkatese te energjise

- Synimi yne eshte qe t’i dergojme ne Parlament brenda ketij viti

Çfare sjellin keto ligje

- 1. Unifikimi i kuadrit ligjor te sektorit te energjise.
- 2. Perafrimi maksimal i tyre me “aquite” komunitare.
- 3. Percaktimi i objektiveve per Rritjen e perdorimit te Energjite e Rinovueshme
- 4. Percaktimi i objektiveve per Rritjen e Eficences se Energjise
- 5. Shtimi i incentivave per perdorimin e burimeve te rinovueshme dhe rritjen e eficences se energjise.

Incentivat qe sigurojne keto ligje

- 1. Feed-in tarife per energjine e prodhuar nga centrale qe perdorin energji te rinovueshme me fuqi te instaluar deri ne 15 MW.
- 2. PPA per blerjen e garantuar te sasise se prodhuar nga centrale me kapacitet deri ne 15 MW per nje periudhe te caktuar kohore;
- 3. Lehtesira ne te drejten e lidhjes dhe transmetimit te energjise elektrike ne rrjetin shperndares dhe ate te transmetimit;
- 4. Marredhenie kontraktuale me transmetuesit e energjise elektrike dhe garanci ne transmetimin e energjise
-
- 5. Lehtesira fiskale
- 6. Dhenien e Certifikatave te Origjines se prodhimit
- 7. Krijimin e fondeve perkatese per mbeshtetjen e ketij sektori

Reforma Strukturore

(STRUKTURA EKZISTUESE)

- Ne zbatim te ketij kuadri ligjor u realizua dhe Reforma Organizative, qe çoi ne ndarjen e shoqerise vertikalisht te integruar KESH sh.a., ne tre shoqeri te ndara ligjerisht, financiarisht dhe ne vendim marrje, sipas funksineve te tyre ne:

1. Gjenerim,
2. Transmetim dhe
3. Shperndarje

dhe konkretisht ne:

Reforma Strukturore

(STRUKTURA EKZISTUESE)

1. Shoqerine KESH sh.a, e cila ka ne perberjen e saj (i) KESH gjenerimin dhe (ii) Furnizuesin Publik me Shumice, qe kane per detyre respektivisht prodhimin e energjise elektrike dhe blerjen e energjise elektrike nga prodhuesit vendas dhe tregtaret vendas dhe te huaj dhe per t'ja shitur ate Operatorit te Sistemit te Shperndarjes per te furnizuar konsumatoret tarifore.
2. Shoqerine OST sh.a, e cila kryen funksionet e Operatorit te Transmetimit te energjise elektrike dhe funksionet e Operatorit te Tregut;
3. Shoqerine OSSH sh.a, e cila kryen funksionet e Operatorit te Shperndarje se energjise elektrike dhe te Furnizuesit Publik me Pakice.

Sikurse shihet edhe nga tabloja e mesiperme, ne kemi realizuar detyrimin thelbesor qe rrjedh nga Paketa e Trete per ndarjen e shoqerise veritalisht te integruar dhe **te tre shoqerite jane ligjerisht te ndara, financiarisht te ndara dhe ne vendim marrje te ndara.**

Enti Rregullator i Energjise

Enti Rregullator te Energjise (ERE) vepron si nje ent i veçant, nen vartesine e Parlamentit,

1. ERE ka buxhet me vete dhe burimet financiare dhe njerezore i siguron nga veprimtaria e vet.
2. Ka kompetence te miratoje tarrifat dhe çmimet e operatoreve te sektorit te energjise per pjesen e rregulluar;
3. Ka kompetence te mbroje konsumatorët;
4. Te marre vendime per operatoret e tregut te energjise se rregulluar dhe licensuar
5. Te penalizojë operatoret qe shkelin rregullat e tregut te energjise

Reforma Strukturore

(STRUKTURA E RE)

- Por, te tre keto shoqeri kryejne nga dy funksione kryesore, te cilat sot realizohen nga struktura te veçanta, por brenda ketyre shoqerive.
- Per te realizuar nje perputhje te plote te strukturave organizative te sektorit elektrik me direktivat e Bashkimit European dhe per te ritur eficencen dhe transparencen, do te vazhdoje reforma organizative ne keto shoqeri

Reforma Strukturore

(STRUKTURA E RE)

- **KESH sh.a do te ndahet ne :**

- (i) **KESH sh.a Gjenerim**, qe do te kete vetem detyren e gjenerimit te energjise elektrike dhe qe do te kete ne administrim te saj vetem hidrocentralet e Vaut te Dejes, te Komanit dhe te Fierze. Ajo do te mbaje kete emer jo vetem per arsye tradite, por edhe te vlefshmerise se shume marreveshjeve dhe kredive, qe jane marre nga kjo shoqeri, ne kohen qe vepronte si shoqeri e integruar.
- (ii). **Furnizuesi Publik me Shumice** do te shkrihet, dhe nga modeli me nje furnizues te vetem me shumice per konsumatorët tarifore, tregu do te liberalizohet.

- **OST sh.a do te ndahet ne:**

- (i) **Operatorin e Sistemit te Transmetimit sh.a**, qe do te kete per detyre te administroje rrjetin ekzistues te transmetimit te energjise elektrike dhe ta zgjeroje ate, dhe
- (ii). **Operatorin e Tregut te energjise elektrike**, qe do te kryeje rolin e Operatorit te Tregut te energjise elektrik.

- **Operatori i Sistemit te Shperndarjes sh.a** (sot CEZ Shperndarje sh.a) do te ndahet ne:

- (i) **Operatorin e Sistemit te Shperndarjes sh.a**, qe do te kete per detyre te administroje rrjetin ekzistues te shperndarjes se energjise elektrike dhe ta zgjeroje ate, dhe
- (ii) **Furnizuesin Publik me Pakice**, qe do te vazhdoje te kryeje rolin e furnizuesit publik me pakice te konsumatoreve tarifore te energjise elektrik

Reforma Strukturore

(STRUKTURA E RE)

Pronesia mbi dy shoqerite kryesore te sektorit elektrike, me kapital 100% shteteror, KESH sh.a. dhe OST sh.a duhet te jete nen vartesine e dy ministrive te ndryshme.

Varjant:

- 1.Njera nga shoqerite te jete nen vartesine e Ministrise pergjegjese per energjine
- 2.Shoqeria tjeter te jete nen vartesine e Ministrise pergjegjese per financat

FALEMINDERIT PER VEMENDJEN TUAJ!

Agim BREGASI: Drejtor i Politikave Elektroenergjetike

agim.bregasi@mete.gov.al